



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot. Tiranë ___/___/2014
Nr. Dok. 201301995/20

Lënda: *Rekomandohet fillimi i procedurës administrative për dhënien e masës disiplinore ndaj ndihmësmjekëve G. Sh., G. S., M. A. dhe mjekut R. P.*

Drejtuar: Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve
Z. Artur ZOTO

TIRANË

Drejtorit të IEVP Sarandë
Z. Arqile VASO

SARANDË

*I nderuar Z. Zoto,
I nderuar Z. Vaso,*

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetësja H. R., e cila pretendon se djali i saj B. R. ka pësuar dëme shëndetësore si pasojë e neglizhencës të IEVP Sarandë për ta dërguar sa më parë për mjekim të specializuar. Më konkretisht, ankuesja shpjegon se, djali i saj, më datë 30 Korrik 2013, ka patur temperaturë të lartë dhe ka kërkuar të marrë mjekim të specializuar. Kjo kërkesë nuk është marrë parasysh nga IEVP Sarandë dhe për pasojë gjëndja e tij shëndetësorë është përkeqësuar duke i shkaktuar paralizë në gjysmën e fytyrës dhe humbjen e shikimit në njërin sy.

Për të bërë të mundur verifikimin e kësaj ankese, nga ana jonë janë kryer disa veprime hetimore si: marrja në pyetje e shtetasit B. R. dhe e stafit mjeksorë, administrimi i disa dokumentave në IEVP Sarandë dhe dërgimi i kërkesës për kryerjen e ekspertimit mejko-ligjor të shtetasit B. R.

Instituti i Mjekësisë Ligjore Tiranë, pasi ka marrë në shqyrtim kërkesën tonë për kryerjen e ekspertimit mejko-ligjor të shtetasit B. R., ka arritur në përfundimin se, stafi mjeksor nuk ka dhënë ndihmë ndaj tij. Si pasojë e mosdhënies së ndihmës mjeksore, B. R. i janë shkaktuar dëmtime të rënda shëndetësore.

Ndërsa nga kqyrja e dokumentacionit të IEVP Sarandë konstatohet se, librat e administruar nga stafi mjeksorë nuk janë plotësuar sipas rubrikave përkatëse dhe mjeku i institucionit nuk ka qenë i pranishëm në regjimin e brendshëm nga data 31.07.2013 deri në datën 04.08.2013, kohë gjatë së cilës B. R. është ankuar për probleme shëndetësore.

Bashkëlidhur kësaj shkrese po ju dërgojmë fotokopje të dokumentave si më poshtë vijon:

- Procesverbal i marrjes në pyetje të shtetasit B. R.;

- Veprimet që kanë kryer ndihmësmjekët dhe mjeku nga dt. 30.07.2013-04.08.2013 si dhe oraret e këtyre veprimeve (të dhëna të nxjerra nga *Libri i regjistrimit të personave që futen në regjimin e brendshëm dhe të pasqyruar më vete për lehtësi referimi*);
- Libri i marrjes në dorëzim të sektorit shëndetësor nga dt. 30.07.2013 deri në dt. 06.08.2013;
- Libri i dhënies së medikamenteve nga dt. 25.07.2013 deri në dt. 12.08.2013;
- Regjistri themeltar i mjekut të përgjithshëm dhe familjes;
- Libri i vizitave dhe dhe shërbimeve në spital;
- Urdhërat për shoqërimin e B. R. i në Spitalin Civil Sarandë dhe Qendrën Spitalore të Burgjeve;
- Informacion i Qendrës Spitalore të Burgjeve për gjëndjen shëndetësore të B. R.;
- Shkresa jonë drejtuar IEVP Sarandë ku pasqyrohen konstatimet tona dhe pyetjet drejtuar stafit mjeksor;
- Përgjigjet e ndihmësmjekëve dhe mjekut të IEVP Sarandë.
- Akt ekspertimi mjeko-ligjor për shtetasin B. R.

Për sa më lart, bazuar në Nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: "*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut*" si dhe në mbështetje të Nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*" (me ndryshimet përkatëse) ku përcaktohet se: "*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.*"

J U R E K O M A N D O J M Ë:

Fillimin e procedurës administrative për dhënien e masës disiplinore ndaj ndihmësmjekëve G. Sh., G. S., M. A. dhe mjekut R. P.

Në bazë të Nenit 22 të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*", lutemi të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi si dhe na dërgoni fotokopje të konstatimeve të mjekut specialist dhe rekomandimeve të tij.

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI

Në Mungesë dhe me Porosi

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI